



Prania / Presenca Presence / Attendance	03.02.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Hi Prot Hi Prot Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	523/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1218/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca -anëtar dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1218/2021 të datës 24.12.2021 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____ në Prishtinë, kundër organit të punësimit-Ministria e Ekonomisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 03.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.1218/2021 të datës 24.12.2021 të parashtruar nga ankuesi _____.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 01.04.2012 në pozitën "Vozitës" në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, tani e ristrukturuar Ministria e Ekonomisë, më datë 17.11.2021 ka parashtruar kërkesë për harmonizim të koeficientit tek Drejtori i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë. Drejtori i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë më datë 23.11.2021 i është përgjigjur ankuesit në kërkesën e tij vozitësi kanë statusin e Nëpunësit administrativ dhe mbështetës sipas deklarimit të statusit të zyrtarëve publikë.

Ankuesi, përmes postës më datë 22.12.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 24.12.2021 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe është regjistruar më numër të ankesës A.nr.1218/2021 dhe Nr. Prot:6330/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 31.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Ekonomisë. Më datë 10.01.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Ekonomisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e datës 24.12.2020 me Nr. Prot:6330/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 01.02.2012 të ankuesit; Përgjigjen në kërkesë e datës 23.11.2021; Kërkesën e datës 17.11.2021 dhe 09.03.2020 e ankuesit për harmonizim të koeficientit; Përgjigje rreth kërkesës e datës 23.06.2020; Kërkesë për shqyrtim -rripte të koeficientit e datës 05.08.2020 nga vozitësit e ish MZHE; Aktvendimin Cp.nr.851/17 i Gjyaktës Themelore në Prishtinë; Zarfën e datës 22.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 10.01.2022; Deklarimi i statusit të zyrtarit publik i datës 01.07.2021; Emailin e datës 03.07.2021 nga Emailin e datë 01.07.2021 nga Emailin e datës 30.06.2021 nga F.Kosumi; Emailin e datës 11.06.2021 nga info.dmzp; Autorizim për shpallje të konkursit i datës 22.05.2013; Kërkesë për aprovimin e nisjes së rekrutimit e datës 16.05.2013; Kërkesë për fillimin e rekrutimit e datës 15.05.2013; Përshkrimi i detyrave të punës vozitës; Vendimin A.nr.301/2020 të datës 04.11.2020 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, është bërë i pamundur, *sepse*:

Duke shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për objektin e njëjtë të ankesës të ankuesit, më datën 04.11.2020 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.301/2020, me të cilin Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është shpall jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit duke konstatuar se pozita "Vozitës" që mban ankuesi nuk hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit civil por hyn në kategorinë e nëpunësve administrative-teknik dhe mbështetës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike"*, konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e datës 24.12.2021 të ankuesit është bërë i pamundur sepse për rastin e ankuesit është vendosur njëherë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër A.nr.301/2020.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1218/2021, datë 03.02.2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.